

## Për adoleshentë: Mirë se vini në kujdesin për adoleshentë

**Ekipi juaj i kujdesit:**

**Orari i vizitave:**

**Për të lënë/anuluar një takim:**

---

Shtëpia mjekësore është një partneritet i besuar mes një ekipi kujdesi shëndetësor dhe një pacienti të informuar (**juve**). Ne ofrojmë kujdes cilësor shëndetësor për adoleshentë dhe të rritur në moshë të re. Ne duam të punojmë me ju dhe familjen/kujdestarin tuaj për t'ju dhënë kujdesin shëndetësor që ju nevojitet.

### Shërbimet që ju ofrojmë si shtëpia juaj mjekësore:

- Kujdes shëndetësor fizik
- Kujdes për shëndetin emocional ose mendor
- Kujdes shëndetësor parandalues (ju ndihmojmë të evitoni sëmurjen në të ardhmen)
- Kujdes për sëmundje afatshkurtra dhe probleme shëndetësore që vazhdojnë me kohën

### Si shtëpia juaj mjekësore do të synojmë:

- **T'ju pyesim** për synimet dhe idetë tuaja për mënyra se si t'ju përmirësojmë shëndetin.
- **T'ju dëgjojmë** dhe të flasim për shqetësimet që mund të kenë.
- **T'ju ndihmojmë** të qëndroni të shëndetshëm duke ju dhënë informacion për kushtet shëndetësore në një mënyrë që mund ta kuptoni lehtë.
- **T'u përgjigjemi** shpejt telefonatave, pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja.
- **T'ju rikujtojmë** kur t'ju duhet të bëni analizat fizike, vaksinat dhe depistimet.
- **T'ju tregojmë** për rezultatet jonormale të analizave sa më shpejt të jetë e mundur.
- **T'ju ndihmojmë** të përcaktoni trajtimin tuaj me ofrues të tjerë të kujdesit shëndetësor apo specialistë të tjerë nëse është nevoja.

### Të keni një shtëpi mjekësore do të thotë që kemi besim se ju:

- Do të mësoni për problemet tuaja mjekësore dhe do të na thoni nëse nuk kuptoni diçka që diskutojmë me ju.
- Do të ndiqni planin e trajtimit për të cilin biem dakord sa më mirë të mundeni.
- **Jini të sigurtë.** Na thoni për historikun tuaj mjekësor, sjelljet e rrezikshme dhe të gjitha mjekimet që merrni.
- Na tregoni nëse keni ofrues të tjerë kujdesi shëndetësor si pjesë të kujdesit tuaj. Kërkojuni të na dërgojnë një raport nëse i vizitoni jashtë klinikës sonë.
- Jini të përpiktë me oraret e takimeve. Nëse nuk mund të vini në takim, telefononi për ta ndryshuar ose anuluar të paktën 24 orë përpara.
- **Ejani në klinikën tonë kur të jeni të sëmurë** duke evituar urgjencën nëse është e mundur. Në këtë mënyrë, për ju do të kujdeset dikush që ju njeh dhe që jua di historikun.
- Regjistrohuni për akses në **portalin tuaj të pacientit MyChart**.
- Na thoni se si mund t'i përmirësojmë shërbimet tona.

**Personeli ynë është në dispozicion për t'i diskutuar problemet tuaja apo për t'iu përgjigjur pyetjeve. Ne duam të punojmë me ju për t'ju ndihmuar të merrni vendimet më të mira për një të ardhme të shëndetshme.**

## Të drejtat shëndetësore për adoleshentët

---

1. Ne nuk do t'ju trajtojmë ndryshe për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, vendit ku keni lindur, statusit të imigrimit, fesë, gjinisë, moshës, orientimin seksual, identitetin apo shprehjes gjinore, invaliditetit apo sigurimit shëndetësor.
2. I gjithë personeli do t'ju trajtojë me respekt.
3. Nëse prindi/kujdestari është me ju, ne do t'i kërkojmë të largohet për një pjesë të vizitës - kjo është koha kur mund të na flisni privatisht. Nëse nuk e keni problem, ne ju sugjerojmë që ta ndani informacionin që diskutoni me ne edhe me prindin/kujdestarin tuaj apo ndonjë të rritur tjetër të besuar në jetën tuaj.
4. Personeli ynë nuk i ndan informacionet tuaja private me persona të tjerë pa rënë ju vetë dakord për këtë (pa dhënë pëlqimin) përveç nëse jeta juaj apo e dikujt tjetër është në rrezik.
  - A) Në përputhje me legjislacionin e shtetit të Nju-Jorkut, të gjithë adoleshentë mund të marrin shërbimet e mëposhtme **pa** lejen e prindit apo të kujdestarit të tyre ligjor:
    - Analiza shtatzënie, kujdes para lindjes, opsione konsulence dhe referime për shërbime abortimi
    - Informacion për kontrollin e lindjeve dhe kontraceptivët
    - Analiza dhe trajtim për infeksione me transmetim seksual (STI)
    - Trajtim kundër përdorimit të substancave
    - Disa trajtime për shëndetin mendor
  - B) Ne e kemi të detyruar të ndajmë disa prej informacioneve tuaja private (me ligj) nëse:
    - Ju i rrëfeni personelit tonë apo ne dyshojmë se një i rritur është duke ju lënduar.
    - Ju i rrëfeni personelit tonë se doni të lëndoni veten.
    - Ju i rrëfeni personelit tonë se doni të lëndoni dikë tjetër.

### **I gjithë informacioni tjetër do të mbetet konfidencial mes jush dhe ekipit tuaj të kujdesit.**

5. Ne punojmë së bashku me ju për të vendosur për kujdesin që keni nevojë. Ju do të merrni kujdesin më të mirë të mundshëm dhe do t'ju shpjegohen opsionet e kujdesit të ofruar.
6. Nëse keni pyetje për të drejtat tuaja apo mendoni se ju kanë keqtrajtuar, jeni të lutur të informoni personelin tonë.

### **Burime në internet**

[Nycyouthhealth.org](http://Nycyouthhealth.org)

[Nyc.gov/teen](http://Nyc.gov/teen)

[Aap.org](http://Aap.org)

[Youngwomenshealth.org](http://Youngwomenshealth.org)

[Youngmenshealthsite.org](http://Youngmenshealthsite.org)